

I. Organizata "QATAR CHARITY" me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson drejtori z. **Mahmoud Abbas Shaker** (pala e parë) dhe:

II. Komuna e Vushtrisë, të cilën e përfaqëson kryetari z. **Xhafer Tahiri**, (pala e dytë).

Me datën 24 / 09 / 2018, lidhën këtë :

Marrëveshje

Neni 1.

Objekt i kësaj marrëveshje është hapja e njëzetë (20) bunarëve për ujë të pijes në Komunën e Vushtrisë, për vende publike apo për familjet me gjendje të rëndë ekonomike. Në projekt përfshihet hapja e bunarit, me thellësi të ndryshme (sipas nevojës) montimi i pompës me pajisjet përcjellëse, vendosja e qeshmes dhe e reklamës.

Neni 2.

Pala e parë Organizata "QATAR CHARITY" merr përsipër të gjitha shpenzimet e realizimit të këtij projekti.

Neni 3.

Nga pala e dytë, kërkohet që të sjellin listat e të propozuarve me numër të mjaftueshëm dhe atyre rasteve që janë më së shumti me nevojë, për arsye të kryerjes së procedurave në kohë më të shkurtër dhe përfituesit të jenë sa më të qëlluar. Gjithashtu pala e dytë duhet të siguroj mjetet logjistike dhe caktoj personin kontaktues në mes organizatës dhe Komunës, për mbrevajtjen e projektit.

Neni 4.

Pas pranimit të listave me të propozuarit si përfitues të mundshëm, vizitat bëhen prej dy palëve (përfaqësuesi i organizatës me punëkryesin dhe përfaqësuesi i Komunës), ku pastaj vlerësimi përfundimtar dhe përzgjedhja e përfituesve bëhet në organizatë.

Neni 5.

Në rast të përfundimit të afatit kohor të caktuar nga Organizata "QATAR CHARITY" dhe mos plotësimi i numrit të kërkuar me të propozuarit e arsyeshëm (sipas rregullores dhe kushteve të organizatës), atëherë numri i projekteve nuk është e domosdoshme të plotësohet mirëpo përfundon vetëm me numrin e projekteve që janë në dispozicion.

Neni 6.

Kjo marrëveshje është e përpiluar në dy kopje, secila nga palët merr nga një.

Vërtetojnë:

Drejtor i organizatës "Qatar Charity"
z. **Mahmoud Abbas Shaker**



قطر الخيرية
Qatar Charity
Kosovo Office

Kryetari i Komunës së Vushtrisë
z. **Xhafer Tahiri**

